

Pjesëmarrja qytetare në draftim të buxheteve komunale



Tetor 2018



DEMOCRACY PLUS

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK

DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

Përgatitur nga: **Roberta Osmani dhe Jetmir Bakija**

E drejta e autorit ©2018. Democracy Plus (D+)

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjeti elektronik, mekanik, fotokopjohet apo të tjera, pa lejen e D+.

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbatja e këtij botimi është përgjegjësi e Demokraci Plus dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

Përmbajtja

Hyrje	4
Hapat e hartimit të buxhetit komunal	5
Përfshirja qytetare në procesin e hartimit të buxhetit komunal	6
Dëgjimet buxhetore në komuna për buxhetin e vitit 2019	7
Sfidat e dëgjimeve buxhetore	9
› Mënyra e informimit të qytetarëve	9
› Faza e vonshme e konsultimit	9
› Pjesëmarrja e ulët e qytetarëve	11
Veprime për përmirësim të procesit të konsultimit për buxhet	12
Konsultimi para hartimit të buxhetit	12
Dëgjimet lagje më lagje	12
Pilotimi i buxhetimit me pjesëmarrje "Participatory Budgeting"	12
Shtojca 1	15

Buxheti është akti më i rëndësishëm komunal që shqyrtohet dhe miratohet në Kuvend Komunal në baza vjetore bazuar në parashikime afatmesme tri vjeçare. Institucionet komunale kanë kompetenca që ndikojnë drejtpërsëdrejti në kualitetin e jetës së qytetarëve duke filluar nga ndërtimi i rrugëve, trotuarëve, shkollave dhe qendrave të mjekësisë familjare e deri tek subvencionimi i veprimtarive ekonomike, agrokulturore e kulturore.

Buxheti që hartohet çdo vit nga të hyrat e parasë publike, përcakton se çfarë projekte dhe shërbime do t'u ofrohen qytetarëve, andaj duhet të jetë i shpërndarë mirë dhe i konsultuar me qytetarët. Me konsolidimin e qeverisjes lokale, buxhetet komunale janë rritur dukshëm dhe janë bërë të rëndësishëm për zhvillimin e lagjeve dhe fshatrave¹. Mirëpo, shumë komuna nuk i japin rëndësinë e merituar konsultimit publik për këtë proces të rëndësishëm, madje në disa raste ka pasur edhe përkeqësim nga vitet e kaluara.

Buxheti i komunës i ka pesë kategori: Paga dhe meditje, mallëra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe investime kapitale. Shuma totale e buxhetit dhe ndarja e tij në pesë kategoritë bëhet nga Ministria e Financave për shkak të rëndësisë së grantit qeveritar në financimin e qeverisjes lokale. Buxheti i komunës kalon në katër faza që janë: hartimi, miratimi, zbatimi dhe rishikimi. Qytetarët mund të japin kontributin e tyre në fazën e parë të bërjes së buxhetit – hartimin, në dy kategoritë e fundit të buxhetit – subvencione dhe investime kapitale, konkretisht në shpërndarjen e shumave të paracaktuara brenda këtyre dy vijave buxhetore.

Kontributi i qytetarëve është i limituar pra në vetëm dy kategori dhe në formë të propozimit për shtim apo heqje të një projekti apo uljes/ngritjes së një shume të dedikuar për një projekt apo subvencion, në një listë tashmë të draftuar nga komuna.

Gjatë fushatës elektorale për zgjedhje komunale 2017, Demokraci Plus u ka kërkuar kandidatëve për Kryetar të shtatë komunave që të zotohen formalisht se do t'u përmbahen disa parimeve bazë të qeverisjes së mirë nëse zgjidhen për ta udhëhequr komunën. Njëra ndër to është zotimi se do të mbahen konsultime publike në lagje dhe fshatra. Pasi që në fazën e hartimit të buxhetit mbahen konsultime me qytetarë, D+ ka monitoruar këto takime për të vlerësuar angazhimin e komunave për t'i konsultuar qytetarët për buxhetin e vitit 2019. Arsyet pse është përzgjedhur ky zotim është që të fuqizohet qeverisja e mirë, bazë e së cilës është pjesëmarrja qytetare në draftim të politikave lokale përfshi buxhetin, për një qeverisje gjithëpërfshirëse. Shtatë komunat më të mëdhat në vend: Prishtina, Prizreni, Ferizaj, Peja, Gjakova, Gjiłani dhe Mitrovica, janë përzgjedhur për monitorim në këtë aspekt për arsye se përmbushja e zotimeve nga këto komuna duhet të shërbejë si shembull për komunat më të vogla përreth në vendosjen e standardeve më të larta të parimeve të qeverisjes së mirë në qeverisjen lokale në Kosovë.

Kjo analizë shqyrton procesin e konsultimit publik për buxhetin komunal në këto komuna si dhe jep sygjerrime se si të përmirësohet ky proces i rëndësishëm i konsultimit.

1 Buxhetet për vitin 2019 të shtatë komunave më të mëdha në vend: Prishtina: 87,733,825.00; Prizreni: 47,430,460.00 Euro; Ferizaj: 30,934,846.00; Peja: 26,598,410.00; Gjakova: 24,785,173.00; Gjiłani: 25,508,785.00; Mitrovica: 19,728,815.00;

Hapat e hartimit të buxhetit komunal

Procesi i draftimit të buxhetit për të gjitha organizatat buxhetore – institucione publike që financohen nga buxheti i Republikës së Kosovës fillon me hartimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) për tre vitet e ardhshme. KASH përpilohet me kontributin e të gjitha organizatave buxhetore bazuar në prioritetet e Qeverisë për tri vitet e ardhshme dhe miratohet nga vetë Qeveria. KASH-i determinon kufijtë buxhetorë, pra shumën maksimale që mund të shpenzohet brenda kategorive buxhetore, dhe në bazë të saj përgatitet Qarkorja Buxhetore për buxhetin e vitit 2019². Qarkorja u dërgohet nga Ministria e Financave të gjitha organizatave buxhetore, ndër to edhe komunave, si udhëzim për përgatitjen e propozim buxhetit për vitin e ardhshëm.

Pasi që ekzekutivi i komunës harton draftin e buxhetit bazuar në procedurat e përshkruara më lartë, ai paraqitet tek qytetarët në formë të dëgjimeve buxhetore, ku pritët nga këta të fundit të japin kontributin e tyre. Ky proces fillon në maj të vitit aktual me shpërndarjen e Qarkores së parë buxhetore, dhe vazhdon deri në fund të shatorit kur edhe miratohen buxhetet komunale në Kuvendet respektive. Procesi pastaj vazhdon me ekzekutim të buxhetit, pra mbledhjen e të hyrave dhe shpenzimin e tyre sipas planit, dhe me rishikimin e buxhetit pas gjashtë muajsh me propozimin e ekzekutivit dhe miratimin nga Kuvendi Komunal.

Diagrami 1: Procedurat e bërjes së buxhetit komunal




2 Ministria e Financave. Qarkoret Buxhetore. <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,31>

Përfshirja qytetare në procesin e hartimit të buxhetit komunal

Dëgjimet buxhetore mbahen me qëllim të marrjes së feedback-ut nga ana e qytetarëve për buxhetin e komunës së tyre. Në këto dëgjime paraqiten informata si: tavanet buxhetore për secilën nga pesë kategoritë buxhetore, apo edhe informata më të detajuara rreth projekteve kapitale, varësisht nga vullneti i komunës. Nga diagrami 2 shihet qartë që përfshirja e qytetarëve në procesin e përgatitjes së këtyre buxheteve bëhet në një fazë tepër të vonshme dhe zakonisht nuk rezulton me ndonjë ndryshim substancial në buxhet. Fakti që në fazën në të cilën përfshihen qytetarët, buxheti është tashmë me tavane të përcaktuara dhe i dedikuar në kategori buxhetore, lë të kuptohet që qytetarët kanë hapësirë tejet të limituar për të dhënë kontributin e tyre.

Po ashtu, procesi i organizimit të dëgjimeve buxhetore shpesh i neglizhon hapat e përcaktuar me legjislacion dhe si rrjedhojë këto takime mbledhin relativisht pak qytetarë. Komunitat janë të obliguara që së paku simbolikisht t'i dëgjojnë interesat e qytetarëve në fazën e finalizimit të draft buxhetit. Konkretisht, Ligji për Menaxhimin e Financave Publike, neni 61 e obligon Kuvendin Komunal pas pranimit të propozim buxhetit të mbajë dëgjime buxhetore dhe më pas ta shqyrtojë dhe ndryshojë (siç e shihet të arsyeshme) draft buxhetin sipas inputit të qytetarëve³. Ndërsa Udhëzimi Administrativ për Transparencë në Komuna ofron detaje se si duhet të informohen qytetarët për takime publike, përfshi dëgjimet buxhetore, dhe detajon procedurat për mbarrëvajtjen e tyre⁴. Në këtë analizë, i referohemi dispozitave të këtij Udhëzimi për të vlerësuar se sa janë respektuar këto kërkesa në organizimin dhe mbajtjen e dëgjimeve buxhetore, si dhe analizojmë angazhimin e komunës për të siguruar pjesëmarrjen e qytetarëve dhe sa në fakt është arritur kjo.

Diagrami 2: Hapësira për pjesëmarrje të qytetarëve në procesin dhe kategoritë e buxhetit komunal



- 3 Ligji për Menaxhimin e Financave Publike. Neni 61 "Shqyrtimi i Buxhetit Komunal nga Kuvendi Komunal", Pika 61.2. Faqe 37. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2524>
- 4 Udhëzimi Administrativ për Transparencë në Komuna. Neni 6 "Takimet me publikun". Faqe 6. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9898>

Dëgjimet buxhetore në komuna për buxhetin e vitit 2019

Komunat janë të obliguara që për mbajtjen e një diskutimi publik (përfshi takimet për buxhetin) duhet të paralajmërohet pubiku të paktën 14 ditë para mbajtjes së takimit përmes shpalljeve publike, mediave, ueb faqes dhe rrjeteve sociale të komunës. Njoftimi duhet të përfshijë informata si data, koha dhe vendi i takimit, dhe të përmbajë rendin e ditës. Këto takime e obligojnë prezencën e Kryetarit të komunës dhe Kryetarit të Asamblesë Komunale si dhe drejtorëve dhe zyrtarëve relevant varësisht nga tema e diskutimit.

Më poshtë paraqiten të dhëna për numrin e dëgjimeve buxhetore, vendin ku janë mbajtur (Kuvend Komunal, lagje të qytetit, apo fshatra), si dhe vlerësimi i përgjithshëm për respektimin e dispozitave bazë të UA për transparencë, për shtatë komunat më të mëdha kryetarët e të cilave janë zotuar për qeverisje të mirë komunale. Në përgjithësi, të gjitha komunat e kanë respektuar afatin kohor prej 14 ditësh për paralajmërim të qytetarëve për dëgjime buxhetore. Po ashtu në të gjitha dëgjimet është treguar shuma totale e buxhetit si dhe ndarja e shumës në pesë kategoritë e buxhetit komunal, apo tavanet buxhetore, përfshi investimet kapitale.

Në komunën e Prishtinës janë mbajtur gjashtë (6) dëgjime buxhetore, edhe pse është komuna me numrin më të madh të banorëve, në këtë komunë janë mbajtur më se paku dëgjime buxhetore. Kryetari i komunës dhe Kryesuesi Kuvendit Komunal nuk kanë qenë prezent në asnjërën nga këto takime, të gjitha të mbajtura në sallën e Kuvendit Komunal, dhe të gjitha brenda orarit zyrtar të punës. Edhe pse të paralajmëruara 14 ditë para mbajtjes, asnjëra nga takimet nuk ka pasur rend të ditës (përveç një fjalie lidhur me temën për të cilën do të flitet në secilin prej takimeve) dhe në asnjërën nuk është paraqitur lista e projekteve kapitale.

Komuna e Prizrenit i ka mbajtur tetë (8) dëgjime, dy prej të cilave janë mbajtur në fshatra dhe gjashtë (6) në Kuvend Komunal. Kryetari ka

qenë prezent në pesë (5) nga tetë (8) takime, ndërsa rend të ditës nuk ka pasur për asnjërin. Megjithatë, komuna e Prizrenit është një ndër tri komunat e vetme që në dëgjimet buxhetore të pranishmëve u ka ofruar listë të plotë të projekteve kapitale sipas draft buxhetit që i është prezentuar të pranishmëve.

Komuna e Ferizajt ka mbajtur 10 dëgjime buxhetore, tetë (8) nga të cilat janë mbajtur në fshatra, një (1) në një lagje të qytetit dhe një (1) në sallën e Kuvendit Komunal. Kryetari i kësaj komune ka qenë prezent në nëntë (9) prej tyre. Të gjitha janë paralajmëruar dy javë para mbajtjes por nuk ka pasur rend të ditës apo listë të projekteve kapitale që u janë dhënë qytetarëve pjesëmarrës për të facilituar diskutimin.

Komuna e Pejës ka mbajtur numrin më të madh të dëgjimeve buxhetore, nga të cilat nëntë (9) në fshatra, dy (2) në lagje të qytetit dhe dy (2) në sallën e Kuvendit Komunal. Kjo komunë ka ofruar rend të ditës për dëgjimet buxhetore por nuk ka paraqitur listë të plotë të projekteve kapitale të përfshira në draft buxhetin e vitit 2019 për pjesëmarrësit në diskutim.

Gjakova ka mbajtur dhjetë (10) takime për buxhetin, në tre prej tyre ka qenë prezent edhe Kryetari i Komunës. Gjakova është një ndër tri komunat që ka paraqitur listën e plotë të projekteve kapitale të draft buxhetit për vitin 2019 por nuk ka pasur rend të ditës për takimet e mbajtura. Njëri nga dëgjimet e planifikuara në lagje të qytetit, konkretisht në lagjen ku banojnë komunitetet jo-shumicë, ka dështuar për shkak të mospjesëmarrjes së qytetarëve.

Gjilani po ashtu ka mbajtur dhjetë (10) takime por Kryetari nuk ka qenë prezent në asnjërën nga to. Megjithatë, kjo komunë është e vetmja që ka pasur rend të ditës dhe listë të projekteve kapitale në secilin nga dëgjimet buxhetore. Po ashtu, në shtatë (7) takimet e mbajtura në komunën e Mitrovicës, Kryetari nuk ka qenë prezent në asnjërin prej tyre. Tri (3) nga takimet janë mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal dhe katër (4) nëpër fshatra.

Tabela 1. Dëgjimet buxhetore për buxhetin e vitit 2019

Komuna	Numri i dëgjimeve buxhetore	Vendi i mbajtjes së dëgjimeve			Prezenca e Kryetarit	Prezenca e Kryetarit të Kuvendit Komunal	Agjendë	Listë të projekteve kapitale
		Kuvend komunal 	Lagje 	Fshat 				
Prishtina	6	6	0	0	0/6	0/6	Jo	Jo
Prizreni	8	6	0	2	5/8	0/8	Jo	Po
Ferizaj	10	1	1	8	9/10	0/10	Jo	Jo
Peja	13	2	2	9	11/13	11/13	Po	Jo
Gjakova	10	1	1	8	3/10	1/10	Jo	Po
Gjilani	10	2	1	7	0/10	0/10	Po	Po
Mitrovica	7	3	0	4	0/7	0/7	Jo	Jo

Sfidat e dëgjimeve buxhetore

Mënyra e informimit të qytetarëve

Një nga sfidat kryesore të dëgjimeve buxhetore është mënyra e informimit të qytetarëve. UA për transparencë i obligon komunat që paralajmërimin e publikut për mbajtje të takimeve publike ta bëjnë përmes shpalljeve publike, mediave, ueb faqes dhe rrjeteve sociale të komunës 14 ditë para mbajtjes së dëgjimit. Edhe pse të gjitha komunat i janë përmbajtur afatit për paralajmërim që është vendosur në ueb faqet zyrtare të komunave respektive, jo të gjitha kanë bërë përpjeke të mëtutjeshme për informim më të gjerë të publikut.

Duke marrë parasysh përdorimin e gjerë të rrjetit social Facebook, ne vlerësojmë që ky është një mjet përmes të cilit mund të arrihet numri më i madh i qytetarëve për informim rreth mbajtjes së dëgjimeve buxhetore dhe për këtë rast nuk është shfrytëzuar mjaftueshëm. Komuna e Prishtinës e cila e ka numrin më të vogël të pjesëmarrësve në dëgjime, e ka vetëm një postim për dëgjimet buxhetore në faqen zyrtare të komunës në Facebook. Në anën tjetër, komuna e Prizrenit ka bërë një postim në faqen e saj të Facebook ku tregohet orari i mbajtjes së dëgjimeve, dhe postime pasuese pas mbajtjes së dëgjimeve ku tregohet se si ka shkuar dëgjimi i caktuar. Komunitet Ferizaj dhe Gjilan i kanë nga pesë (5) postime përmes të cilave i informojnë dhe inkurajojnë qytetarët të marrin pjesë në takime, ndërsa komuna e Gjakovës i ka gjashtë (6). Komuna e Mitrovicës pas postimit të parë me orarin e plotë të dëgjimeve, ka bërë edhe tre (3) postime njoftuese para mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, dhe nga një postim (total shtatë) pas secilit dëgjim buxhetor të mbajtur. Ndërsa komuna e Pejës i ka bërë shtatë (7) postime në ditë të ndryshme për të njoftuar qytetarët për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore.

Mirëpo, përveç Kryetarit të komunës së Prizrenit i cili e ka bërë një postim, asnjë nga Kryetarët e komunave nën monitorim nuk i kanë përdorur faqet e tyre zyrtare të rrjetit social Facebook për t'i informuar apo inkurajuar qytetarët të marrin

pjesë në dëgjime buxhetore. Edhe pse disa nga komunat e monitoruara e kanë përdorur këtë mjet informues nga faqet e tyre zyrtare, ne vlerësojmë se ftesa për qytetarët duhet të vijë edhe nga vetë Kryetari që ua ka kërkuar votën dhe besimin për të udhëhequr me komunën, të jetë më informuese dhe më inkurajuese në mënyrë që qytetarët, ndër të tjerash, ta kuptojnë procesin por edhe rëndësinë e tyre në dhënien e opinionëve se si duhet të shpenzohet buxheti i komunës së tyre.

Sfidë tjetër është informimi për kufizimet dhe strukturën e buxhetit. Në dëgjimet buxhetore të shtatë komunave nën monitorim, shumica e tyre nuk kanë pasur kopje të draft buxhetit apo agjendë në paralajmërimin apo kopje të tyre në vendet ku janë mbajtur takimet. Kjo i lë qytetarët të pa përgatitur për diskutim dhe e dekurajon pjesëmarrjen e tyre. Gjithashtu, shumica e takimeve për buxhetin nuk kanë pasur agjendë apo listë të projekteve kapitale apo subvencioneve të cilat do t'i ndihmonin qytetarët pjesëmarrës për të dhënë kontributin e tyre në ato kategori ku mund të bëjnë ndryshime.

Faza e vonshme e konsultimit

Pjesëmarrja qytetare në draftim të buxhetit të komunave bëhet në një fazë tejet të vonshme për të marrë kontribut të mirëfilltë nga qytetarë të informuar. Vetëm tri (3) nga shtatë (7) komunat nën monitorim: Ferizaji, Gjilani dhe Prizreni, kanë mbajtur takime me publikun edhe për Kornizën Afatmesme Buxhetore, para fillimit të periudhës së dëgjimeve buxhetore.

Në dëgjimet buxhetore qytetarëve u paraqiten tavanet e buxhetit në secilën kategori dhe në disa raste edhe lista e projekteve kapitale. I vetmi propozim për ndryshim që mund të bëhet në këtë fazë është shtimi apo heqja e ndonjë projekti kapital, apo ndryshimi i shumës së ndonjë projekti kapital apo subvencioni. Në shumicën e rasteve, pasi që pjesëmarrja

e qytetarëve në buxhetim është vetëm një aktivitet dhe jo proces, në këtë ngjarje marrin pjesë pak qytetarë dhe ata që vijnë nuk janë mirë të informuar nga komuna për hapësirën që kanë për dhënie të ideve. Për të ilustruar ndikimin e ulët që e kanë qytetarët në ndikim në buxhet të komunës, shembull e kemi marrë komunën e Gjakovës e cila është njëra ndër dy komunat e vetme nën monitorim që e ka paraqitur tabelën e plotë të projekteve

kapitale në dëgjime buxhetore. Krahassimi i kategorisë së investimeve kapitale të draft buxhetit dhe buxhetit të miratuar tregon që draft buxheti nuk ka pësuar shumë ndryshime edhe pas konsultimeve publike. Një arsye pse ka ndodhur kjo mund të jetë fakti që dëgjimet buxhetore janë mbajtur në një fazë tejet të vonshme dhe shumë afër datës së miratimit në kuvend (takimet janë mbajtur në periudhën 5-13 shtator 2018).

Tabela 2. Draft buxheti dhe buxheti i miratuar i Komunës së Gjakovës, kategoria “Shpenzimet Kapitale”

Kategoria	Draft Buxheti	Buxheti i miratuar	Diferenca
Administrata e Përgjithshme	190,000.00	280,000.00	Shtohet linja «renovimi i objektit të komunës».
Buxhet dhe Financa	454,309.00	468,186.00	Rritet shuma e alokuar për linjën «projektet e ndryshme kapitale me bashkëfinancim».
Shërbimet Publike	4,031,459.00	4,137,459.00	Rritet shuma për 2.5%. Ndryshimet nga draft buxheti në buxhetin e miratuar: • Katër projekteve për asfaltim të rrugëve lokale u janë shtuar mjete shumave ekzistuese; • Dy projekteve për asfaltim të rrugëve lokale u janë hequr mjete shumave ekzistuese; • Dy projekte për ndërtim/asfaltim të rrugëve lokale janë hequr; • Dy projekte që nuk kanë qenë në draft buxhet janë shtuar (ndriqim publik dhe kanalizim)
Buxhet dhe Financa	12,000.00	12,000.00	
Bujqësia	350,000.00	350,000.00	
Zhvillimi Ekonomik	346,000.00	346,000.00	
Kadastra dhe Gjeodezia	760,000.00	760,000.00	
Urbanizmi	170,000.00	170,000.00	
Shëndetësia - Administrata	0	1,000.00	Kategoria nuk figuron në draft buxhet por shtohet në buxhetin final.
Shëndetësia - Shëndetësia Primare	207,000.00	240,000.00	Shtohen 11 linja të reja dhe rritet shuma për 33,000 Euro.
Shërbimet Sociale	20,000.00	36,000.00	Shtohen pesë linja të reja dhe rritet shuma për 16,000 Euro.
Kultura, Rinia dhe Sportet – Shërbimet Kulturore	163,000.00	163,000.00	
Kultura, Rinia dhe Sportet – Rinia	12,000.00	12,000.00	
Arsimi	461,183.00	531,183.00	Rritet shuma për 80,000 Euro
Totali	7,176,951.00	7,506,828.00	

Në tabelën numër 2 krahasohet kategoria buxhetore e investimeve kapitale në draft buxhet dhe buxhet të miratuar. Fillimisht, shuma e kategorisë buxhetore "Investimet kapitale" e paraqitur në dëgjime buxhetore është 7,176,951.00 Euro, ndërsa shuma për këtë kategori në buxhetin e miratuar për vitin 2019 është 7,506,828.00 Euro.

Shuma totale e investimeve kapitale ka ndryshuar për vetëm 4.5% pas diskutimeve publike. Siç shihet nga tabela, në kategorinë e shërbimeve publike, në nënkategorinë e projekteve kapitale nga draft buxheti në buxhetin e miratuar kryesisht kemi heqje dhe shtime të projekteve por shuma totale rritet me vetëm 2.5%. Konkretisht janë hequr katë projekte, janë shtuar dy projekte që nuk kanë qenë në listë që është diskutuar në dëgjime, dhe për katër projekte tjera ka ndryshuar shuma (për dy projekte ka ulje dhe për dy ka ngritje të shumave). Ky shembull ilustron që ndikimi i dëgjimeve buxhetore për buxhete komunale është tejet i ulët dhe një ndër shkaqet kryesore është konsultimi në fazë kaq të vonshme që nuk i lejon as komunës të bëjë ndryshime drastike në draft buxhete si rrjedhojë e inputit qytetarë. Arsye tjetër mund të jetë pjesëmarrja e ulët e vetë qytetarëve.

Pjesëmarrja e ulët e qytetarëve

Sfida tjetër dhe rezultat i të gjitha sfidave të lartëpërmendura është mos-pjesëmarrja e qytetarëve në dëgjimet buxhetore. Për ilustrim të kësaj sfide shërben më së miri Komuna e Prishtinës. Kryeqyteti dhe komuna me numrin më të madh të banorëve ka pasur mesatarisht pesë (5) qytetarë në dëgjime buxhetore (numri më i lartë ka qenë 10 pjesëmarrës, dhe numri më i vogël ka qenë zero që konsiderohet si takim i dështuar). Këtu ka mundur të kontribuojnë një sërë faktorësh duke filluar nga fakti që të gjitha dëgjimet janë mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal (Prishtina është e vetmja komunë që asnjë dëgjim buxhetor nuk e ka mbajtur në lagje apo fshatra). Për më tepër, të gjitha dëgjimet janë mbajtur brenda një jave të korrikut, dhe të gjitha janë mbajtur brenda orarit zyrtarë

të punës. Po ashtu, në asnjërin nga dëgjimet buxhetore nuk kanë qenë prezent Kryetari apo Kryesuesi i Kuvendit Komunal, e në disa raste as drejtorët e drejtorive për të cilat është diskutuar konkretisht në takime. Këto elemente, ndër të tjerash kanë mundur të kenë kontribuar në pjesëmarrje kaq të ulët të qytetarëve.

Në anën tjetër, komuna e Pejës mund të shërbejë si shembull i mirë, me mbajten e 13 dëgjimeve buxhetore, nëntë (9) prej tyre në fshatra, dy (2) në lagje të qytetit dhe dy (2) në sallën e Kuvendit Komunal. Kryetari dhe Kryesuesi i Kuvendit Komunal kanë qenë prezent në 11 prej 13 prej tyre dhe të gjitha dëgjimet janë mbajtur pas orës 17:00 që i ka mundur qytetarëve që janë me orarë të plotë në punë, të marrin pjesë.

Edhe pse pjesëmarrja nuk ka qenë e kënaqshme në asnjërin nga komunat, disa nga komunat tjera nën monitorim kanë arritur të tërheqin numër konsiderueshëm më të madh se sa Prishtina. Për shembull në Prizren dëgjimet buxhetore i kanë pasur mesatarisht nga 30 qytetarë pjesëmarrës (numri maksimal ka qenë 40, minimali 20), në Mitrovicë nga 28 pjesëmarrës (numri varion nga 70 maksimal në 8 minimal), në Ferizaj kanë qenë kryesisht nga 20-25 pjesëmarrës, e kështu me rradhë. Megjithatë në asnjërin nga komunat nën monitorim, nuk ka pas pjesëmarrje të kënaqshme apo përfaqësuese në proporcion me popullatën rezidente të komunës.

Veprime për përmirësim të procesit të konsultimit për buxhet

Konsultimi para hartimit të buxhetit

Sfida kryesore e përfshirjes së qytetarëve në procesin e buxhetimit komunal është fakti që buxheti që u paraqitet atyre, është tashmë i përpiluar nga Zyra e Kryetarit dhe në fazën kur mbahen konsultimet është e vështirë që të ndryshohen vijat buxhetore dhe/ose shumat e alokuara. Qytetarët duke parë se propozimet e tyre nuk kanë ndonjë fuqi ndikuese në buxhet, janë dekurajuar dhe hezitojnë të marrin pjesë në dëgjime. Andaj, një zgjidhje e thjeshtë dhe praktike do të ishte që të praktikohet mbajtja e konsultimeve nga zyra e Kryetarit para përpilimit të projekt-buxhetit.

Dimenzioni tjetër në të cilin duhet të punohet është informimi i qytetarëve. Në një dëgjim buxhetor, qytetarët për herë të parë dëgjojnë për kufizimet që i ka buxheti në tërësi nga përcaktimet e Ministrisë së Financave, dhe në disa raste ju tregohet edhe një listë e projekteve kapitale, por nuk kanë informata paraprake që të përgatiten për diskutim.

Takimet duhet të mbahen në një fazë shumë më të hershme se sa që bëhet aktualisht, në mënyrë që qytetarët të kenë mundësinë t'i shprehin nevojat dhe propozimet e tyre për investime në lagjet e tyre dhe që ky input qytetarë të reflektohet në buxhet që në fazat e para të hartimit. Kjo do t'i inkurajonte qytetarët të marrin pjesë në dëgjime pasi që në këtë mënyrë e shohin mundësinë reale që idetë e tyre të dëgjohen dhe të ndikojnë në alokimin e fondeve publike.

Dëgjimet lagje më lagje

Dëgjime e organizuara në ndërtesa të komunave nuk janë tërheqëse për qytetarë, siç u vërtetua me rastin e komunës së Prishtinës. Kryetarët e këtyre shtatë komunave nën monitorim, janë zotuar se do të mbajnë takime me qytetarë në lagje dhe fshatra. Është shumë më efektive nëse

institucionet komunale planifikojnë të shkojnë në çdologje dhe në çdorajontë komunës për dëgjime buxhetore, në fazë më të hershme të procesit të hartimit. Kryetarët e këshillave të fshatrave janë resurs që mund duhet të shfrytëzohet në këtë aspekt, sidomos në koordinim të kohës, datës, dhe lokacionit ku mund të kenë qasje numër më i madh i qytetarëve, dhe të arrihen edhe grupet e marginalizuara siç janë gratë, të rinjtë dhe komunitetet jo-shumicë. Ndër të tjerash, është shumë më inkurajuese për qytetarin që të marrë pjesë në një diskutim në lagjen e saj/tij sepse fokusi i diskutimit ngushtohet tek lagjja respektive dhe lejon më shumë vend për diskutim të detajuar për specifikat lokale.

Pilotimi i buxhetimit me pjesëmarrje "Participatory Budgeting"

Për tejkalimin e sfidave dhe zgjimin e interesit qytetarë për të marrë pjesë në procesin e buxhetit duhet më shumë hapësirë për propozime qytetare, faza më të hershme të konsultimit, dëgjime më të fokusuara dhe punë më e ngushtë me lokalitete. Inkuadrimi i qytetarëve në procesin e draftimit të buxhetit mund të jetë në shkallë dhe mënyra të ndryshme. Inkuadrimi i shkallës më të lartë është në formën e buxhetimit me pjesëmarrje. Modeli i "buxhetimit me pjesëmarrje" paraqet një mundësi të mirë në këtë drejtim. Mirëpo, që ky modalitet të funksionojë, duhet së pari të kuptohet mirë nga vetë zyrtarët komunal, të ketë vullnet për dedikim të resurseve njerëzore dhe financiare të komunës në këtë drejtim, si dhe në përgatitjen e qytetarëve.

Buxhetimi me pjesëmarrje si koncept u prezantua për herë të parë nga tre kryetarë komunash në një qytet në Brazil, i quajtur Porto Alegre në vitin 1989 si rezultat i një sërë reformash në një

situatë me shkallë të lartë të varfërisë në qytet dhe qasjes së dobët në shërbime publike si uji, shkollat dhe shërbimet mjekësore⁵. Ky proces ka sjell rezultate pozitive të vërtetuara në këtë qytet por edhe në të gjitha vendet tjera që e praktikojnë. Në Porto Alegre për shembull ka rritur numrin e shkollave, të banesave për banim kolektiv dhe ka siguruar rrjet më të mirë të ujit dhe kanalizimit⁶. Nga ajo kohë, buxhetimi me pjesëmarrje është pjesë integrale e procesit të buxhetimit në nivel lokal në 1,500 vende të botës si në Amerikë, Europë, Afrikë dhe Azi⁶. Shkalla në të cilën buxheti i përgjithshëm është planifikuar përmes buxhetimit me pjesëmarrje ndryshon. I gjithë buxheti mund të konsiderohet pjesëmarrës, ose një sasi e tij mund të identifikohet nga komuna për t'u rezervuar për "buxhetim me pjesëmarrje" si përqindje e buxhetit të përgjithshëm, ose vetëm një përqindje e shumës së dedikuar për investime⁷.

Zgjidhja më e mirë për Kosovën do të ishte një përqindje e caktuar e buxhetit të përgjithshëm, që korrespondon me një pjesë të konsiderueshme të buxhetit të investimeve kapitale. Është e rëndësishme që të kuptohet se pjesëmarrja qytetare në procesin e buxhetimit është një proces dhe jo një aktivitet në formën e një takimi apo dëgjimi buxhetor. Për pjesëmarrje të qytetarëve në një formë më të avansuar se kjo që është aktualisht në Kosovë, duhet të ketë vullnet nga ana e ekzekutivit dhe legjislativit të komunës që së pari të dedikojnë buxhet dhe resurse njerëzore për një proces që do të jetë cikël i rregullt që zgjat përgjatë tërë vitit.

Në mungesë të vetë iniciativave qytetare për aktivizëm dhe përfshirje në vendimarrje, si dhe në mungesë të angazhimit të vetë komunave për nxitje të inkuadrimit qytetarë në politikëbërje, arritja e buxhetimit me pjesëmarrje do të jetë një proces sfidues. Në mënyrë që të ketë sukses një iniciativë e tillë kërkon angazhim të madh nga ana e ekzekutivit dhe e legjislativit të komunës,

por edhe interesim dhe organizim nga qytetarët. Iniciativa për fillim të këtij procesi mund të vij nga ndonjë Kryetar, këshilltarë i asamblesë komunale apo edhe nga vetë komuniteti.

Megjithatë, duke e parë mungesën e angazhimit qytetarë, kjo iniciativë do të duhej të fillonte nga ndonjë Kryetar. Ky proces duhet të fillojë me informim të qytetarëve që jetojnë në lagje dhe fshatra të komunës, dhe fuqizim të tyre përmes njoftimeve dhe takimeve të rregullta. Pastaj, duhet të krijohen grupe punuese në baza tematike dhe të ofrohen hapësirë për diskutime dhe konsultime të rregullta. Nga këto do të krijoheshin grupe punuese për shkëmbim idesh dhe dhënie të propozimeve në diskutime publike që i paraprijnë buxhetit. Pasi që kjo ide është e re për komunarët dhe qytetarët në Kosovë, kjo duhet të fillojë si pilot projekt në ndonjë lagje apo fshat dhe pastaj të zgjerohet në komunat tjera.

Një version më pak i sofistikuar i "buxhetimit me pjesëmarrje", janë dëgjimet buxhetore të organizuara nga komunat në Kosovë. Këto dëgjime janë aktivitete individuale që replikohen disa herë (varësisht nga komuna) dhe organizohen nga vetë komuna me qëllim të marrjes së feedback-ut qytetarë për dy kategoritë e buxhetit në të cilat mund të ndërhyhet, por edhe aty në mënyrë shumë të kufizuar. Qytetarët në këto takime, dëgjojnë nga komunarët për tavanet e kategorive të buxhetit dhe pastaj japin propozimet e tyre për investime dhe subvencione në komunën e tyre. Këto takime edhe pse janë tejet "pasive" në aspektin e përfshirjes së mirëfilltë të qytetarëve në proces të buxhetimit, formalisht ofrojnë mundësi për qytetarët që të mësojnë për buxhetin dhe të bëjnë përpjekje për inkuadrim të ideve të tyre brenda tij. Por shpeshherë, komunat nuk i respektojnë as kërkesat bazike të legjislacionit në fuqi për procedurat që duhet të ndiqen për motivimin e qytetarëve për pjesëmarrje.

